



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084),
- Dispozitat e Nenit 9.3 të Kodit të Rrjetit të Transmetimit – Dispozita të Përgjithshme,
- Dispozitat e Nenit 10 dhe 11 të Doracakut të raportimit për sektorin e energjisë,
- Kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit “Raporti i Derogimeve-Kodit të Rrjetit Transmetimit”, të datës 08.06.2022 të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT Sh.A),

në seancën e mbajtur me datë 24.06.2022, nxori këtë:

## V E N D I M

- I. APROVOHET kërkesa e KOSTT SH.A. për Derogimet e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit të Transmetimit (Kodi Operativ-5.5.4 Reduktimi nga nënfrekuenca, 5.8.11 Testimi i startimit nga errësira, 8.4.2 Testimet e sistemit) deri me datë 31 dhjetor 2022, si në shtojcën e këtij Vendimi.

## Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A., të datës 08.06.2022 (Nr.1133, dt.09.06.2022) për “Derogimet nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit” të OST-së.

KOSTT SH.A në pamundësi të zbatimit të dispozitave të Kodit të Rrjetit, për vite me radhë ka kërkuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji derogim të tyre, duke dhënë edhe arsyetimin për pamundësinë e zbatimit të tyre.

Shtyrjen e afatit (derogimin) e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit po ashtu ZRRE ka arsyetuar si më poshtë:

- **Kodi i Rrjetit:**

- **Kodi i Operativ**

5.5.4 Reduktimi nga nënfrekuenca, - nuk mund të realizohen në pjesën veriore të vendit deri sa të krijohen kushtet për rehabilitimin e NS Vallaç.



**5.8.11 Testimi i startimit nga errësira** - nuk mund të realizohen sepse nuk mund të sigurohet puna në "ilotazhë" e njërive gjeneruese të KEK-ut, e poashtu nuk ka marrëveshje me OST-të tjera për simulim të startimit nga errësira, me çka nënkuptohet se konsumi vendor duhet të mbetet pa furnizim deri të kthehen njësitë gjeneruese vendore në operim normal.

**8.4.2 Testimet e sistemit** - ndërlidhet me dispozitën 5.8.11 si më sipër, dhe nuk mund të realizohet sepse KOSTT nuk ka marrëveshje me OST-të tjera për simulim të startimit nga errësira.

Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës sipas Raportit të Derogimeve të dispozitave të Kodit të Rrjetit të OST ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Të gjitha dispozitat tjera të "Kodit të Rrjetit të Transmetimit – Dispozita të Përgjithshme", mbesin në fuqi.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.


**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodhë e fundit.

**Bashkëngjitur: "Raporti i Derogimeve\_Kodi i Rrjetit Transmetimit" 24 qershor 2022**

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të ZRRE-së


Bordi i ZRRE-së:

  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

  
Lutfije Dervishi, anëtare

  
Gani Buçaj, anëtar